



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 839/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.12.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-89869-10-15-2018, me objekt “Blerje UPS 3 (tre) fazor për Reanimacionin e SUT”, me fond limit 2.957.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

**Ankimues:**

“ABI ESSE” sh.p.k.  
Rruga “28 Nëntori”, Nr.73, KP 1051, Kashar, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Universitar i Traumës  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

**Baza Ligjore:**

*Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për*

*miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.10.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-89869-10-15-2018, me objekt “Blerje UPS 3 (tre) fazor për Reanimacionin e SUT”, me fond limit 2.957.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, në datën 22.10.2018, operatori ekonomik ankimues “ABI ESSE” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...]Ne datën 16.10.2018 është publikuar në sistemin elektronik të APP-se: procedura e prokurimit me objekt "Furnizim Vendosje UPS 3 (tre) fazor për Reanimacionin e SUT" me Autoritet Kontraktor Spitali Universitar i Traumës me fond limit 2 957 000 leke pa TVSH, tender i cili zhvillohet me datë 26.10.2018. Pasi kemi studiuar skedën teknike për UPS 3 fazor të kërkuar në këtë objekt me Nr Reference: REF-89869-10-15-2018, arrijmë në konkluzionin se kriteret e vendosura për UPS e këtij prokurimi janë në kundërshtim të plote me "Ligjin e Prokurimit Publik" nr 9643 datë 20.11.2006, VKM Nr 914 datë 29.12.2014, "Për miratimin e Rregullirave Publik", konkretisht, Neni 1 (objekti dhe qellimi i objektit që prokurimet), Neni 20 (Mosdiskriminimi), Neni 23 (Specifikimet teknike për objektin që prokurimet), pasi Neni 23 i Ligjit të Prokurimit Nr 9643 datë 20.11.2006 si dhe Rekomandimit me Nr 8197 Prot, i datës 03.09.2018. Duke ecur në një linjë me ligjet e APP-së, qëllimin dhe funksionin e saj, si dhe parregullsitë që vëmë re, e shtojmë ankesën Tona si OE si më poshtë:

Referuar specifikimeve teknike (Shtojca 9) kërkohet UPS (cope 1), 3 fazor me hyrje 400 V, 50 Hz me fuqi 60KVA/48KË dhe me dalje 380 V, 50 Hz, Sinusoidal, të fete online dhe të 3 Hyrje dhe 3 dalje me pavarësi kohore 20 minuta pa shkeputje dhe certifikuar me sistemin CE.

Nëse citojmë shtojcën 9, pika dy e kësaj shtojce shprehet në këtë formë: "UPS duhet të ketë minimalisht karakteristikat e mëposhtme"

Paqartësia jone si OE fillon që në këtë pikë të këtij objekti tenderimi, konkretisht për kuptimin e fjalës "minimalisht" pasi kuptimin e saj është mjaft i gjërë.

Pyetja konkrete është se "UPS 3 fazor që tenderohet në këtë objekt prokurimi ka dhe karakteristika të tjera?"

Në çfarë koncepti është shtruar kjo fjalë, pasi nëse lexojmë fjalën "UPS duhet të ketë minimalisht karakteristikat e mëposhtme" nënkuptohet që mund të ketë edhe karakteristika të tjera, e nëse ka dhe karakteristika të tjera i bie që nuk kemi të bëjmë me të njëjtin UPS 3 fazor pasi një karakteristike ndryshe nga këto që janë publikuar ndryshon objektin e prokurimit.

Ju lutemi të na sqaroni konceptin e lartpërmendur.

Në kërkesat teknike të përshkruara minimale ka disa paqartësi dhe formulime që mendojmë se janë shprehur keq konceptin inxhinierik, teknik si vijon

➤ Pika Nr.5 INPUT :

5.3 Tek Përshkrimi "RRYMA E TENSIONIT" me Karakteristika teknike "(- 15)% (+20%)".

Termi i shprehur në pikën "5.3" të skedës është i gabuar dhe në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik nr 9643 datë 20.11.2006. VKM Nr 914 datë 29.12.2014, "Për miratimin e Rregullave Publik", ndryshuar me Ligjin Nr 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr 9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr 10170, datë 22.10.2009, Ligjin nr 10 309 datë 22.07.2010, Ligjin nr 22/2012, Ligjin nr 131/2012 dhe Ligjin Nr 182/2014, konkretisht Neni 23, "Specifikimet teknike" ku qartësisht shprehet se:

Pika 1- Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plote të gjithë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurim të paanëshernë e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

*Pika 2- Specifikimet teknike duhet të mundesojne trajtim të njejte per të gjithë kandidatet dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengese per konkurimin e hapur per prokurimin publik.*

*Pika 3- Specifikimet teknike duhet të përshkruajne qarte kerkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

- a) Standarteve kombetare, qe mbesh teten ne ato nderkombetare, miratimeve teknike nderkombetare, specifikimeve teknike të pergjithshme, standarteve nderkombetare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të percaktuara nga organet nderkombetare të standartizirnit. Kur keto nuk ekzistojne, ato u referohen standarteve kombetare, miratimeve teknike kombetare ose specifikimeve teknike kombetare.*
- b) Kerkesave ne terma funksionale, kur nje gje e tille kerkon t'u referohesh standarteve kombetare ose nderkombetare, si menyre qe nenkupton pajtueshmeri me kerkesat funksionale;*
- c) Te dyja metodave të percaktuara ne shkronjat "a" dhe "b" të pikes 3 të ketij neni per mallra, sherbime apo pune to ndryshme, të perfshira ne të njejtin objekt kontrate . Cdo reference duhet të shoqerohet nga fjalet "ose ekuivalent i tij/saj"*

*Pika 4- Pershkrimi i punimeve, mallrave apo sherbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, qe duhet të plotesohen ne rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Ne rast të pershkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajne ne menyre të sakte dhe neutrale qellimin e punimeve per njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rendesi per hartimin e e ofertes. Nga pershkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dale jo vetem qellimi i punes se kryer, por edhe kerkesat qe kane lidhje me kete punim nga pikpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Qe të garantohet krahasueshmeria e ofertave per kerkesat e objektit të kontrates per keto punime ose per funksionin e tyre, kerkesat e rendimentit dhe funksionit duhet të jene të sakta per t'u dhene konkurruesve dhe ofertuesve nje ide to qarte ne pergatitjen e ofertes. Ne pershkrimin e punimeve duhet të shenohen, kur eshte rasti, edhe specifikimet per furnizimin e mallrave apo sherbimeve, të pershtatshme per mjedisin.*

*Pika 5- Specifikimet teknike nuk duhet të kene asnje kerkese apo reference të ndonje marke apo erner të vecante, patente, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose siperniarres sherbimi, pervec rasteve kur nuk ekziston nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuptueshme, e pershkrimit të kerkesave, me kusht fjalet "ose ekuivalent" të perfshihen detyrimisht ne keto specifikime. Jo me kot cituam pike me pike Nenin 23 si me lart , si per t'iu vene ne kujtese duke bere nje paralelizem ndermjet asaj qe kerkohet ne Piken 5.3 të skedes teknike per UPS 3 fazor dhe kahut të kundert qe ka kjo pike me Ligjin dhe nenin specifik.*

*Ne lidhje me konceptin teknik të "Rrymes Elektrike " dhe "Tensionit" jane dy parametra teknik të ndryshem dhe respektivisht duhet të shprehen me parametrat teknik të ndryshem, mangesi kjo ne dokumentacionin e paraqitur nga ana Juaj si AK ne kete procedure prokurimi.*

Ne piken 5.3 eshte kerkuar "Rryma e Tensionit" me karakteristike Teknike "(-15)% (+ 20)% duke vendosur keshtu nje "vlere fikse" dhe jo nje interval, pasi duke vene kete parameter fiks kjo procedure prokurimi realizohet me "Ligjin Tuaj të perjashtimit" dhe jo me ligjet funksionale të Prokurimit Publik. Nqs do hyjme ne konceptin e karakteristikes teknike per kete parameter ju shjtellojme qartesisht ate cfare Ju keni kerkuar dhe kuptimin e vleres fikse ne kete parameter qe ne pamje të pare duket interval !!

E shprehur me qarte, ne kete karakteristike teknike kerkohet Pika maksimale e rregullimit të tensionit dhe Pika minimale e rregullimit të tensionit, qe nga ana Juaj si AK jane vene ne vlera fikse (15%)(+20%), gje qe eshte ne kundërshtim me ligjin e LPP-se nenet e tij. Nqs duam të dalim jashte kuadrit të vlerave fikse, të ecim ne nje linje me ligjin e LPP-se qe të mos cenohemi nga kjo procedure prokurimi, kerkojme qe kesaj karakteristike i duhet shtuar fjala perfshire!

Qe do të thote per kete pike ju si AK duhet të shpreheni :  $(-15)\% < V < (+20)\%$ . Tashme jemi ne kushtet e nje intervali (cfare dhe ligji kerkon) dhe tashme jerni ne kushtet e një gare të hapur per të gjithë OE.

Kerkojme nga ana Juaj si AK qe per karakteristiken e më lartkerkuar të rishikohet dhe të behen ndryshimet e nevojshme sipas ligjit, konkretisht, duke krijuar interval duke e lene me të gjere diapazonin e kesaj karakteristike teknike , duke zgjeruar keshtu edhe diapazonin e pjesemarrjes se OE, mbështetur ne kriterin baze të LPP dhe funksionit të saj duke rritur eficensen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik, të kryera nga AK, të siguroje siguroje mirepërdimin e fondeve dhe dhe të ulë shpenzimet proceduriale, të nxise pjesemarrjen e OE, dhe të nxise konkurrencen e OE (Ligji I LPP-se Neni 1 "objekti dhe Qellimi", Pika 2, a,b,c,d).

5.4. Nese kalojme tek kjo pike e skedes teknike Pershkrimi "GAMA E TENSIONIT (64% ngarkesa) " me Karakteristika teknike "(-45)% (+20%)"jemi serish ne të njëjtën "linje diskriminimi" si me siper të vendosjes se nje vlere fikse dhe jo të nje intervali pasi të dhenat teknike të kerkuara "(45)% (+20%)", nuk perbejne interval të nje karakteristike teknike por të nje "intervali percaktues" pasi nqs flasim per të dhena teknike jemi ne kushtet e tolerances ose me sakte intervali qe nuk ndryshon thelbi dhe nuk devijojrne nga qellimi por vetem sa zgjerohet diapazoni i OE pjesemarres pa ndryshuar qellimin dhe objektin e prokurimit. Nqs do na duhet të ecim ne nje linje me ligjin e prokurimit ky parameter duhet shprehur ne kuptimin e nje inetervali, qe do të thote te jemi ne linjen e fjalës "perfshire" e cila e shprehur teknikisht shprehet ne vlerat e mosbarazimit "<".

Kushti i shprehur ne piken 5.4 ka formulim dhe kerkese jo të sakte kerkohet nje pajisje qe duhet të funksionojë ne sistem 3 Fazor me tension 400V dhe jo the tolerance teknike 45% ne vleren 220 V per të cilen detyrimi ligjor i OSHEE sipas ligjit Nr 43/2015 me nenet perkatese të tij, konkretisht, neni 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe nenit 94, 96 " Per Sektorin e Energjise Elektrike", dhe referuar kontrates tip, pika 15.5, ku shprehet qarte se per kryeqytetin eshte detyrim të furnizojë energjine me cilesine e tensionit ne masen  $\pm 5\%$ .

5.7. Ne piken 5.7 të skedes teknike, konkretisht "GAMA E FREKUENCES PER OPERIM ONLINE" jepet Karakteristika teknike "( 45 65 Hz)". Duke qene se sistem i furnizimit me energji ne sistemit e shperndarjes të entit OSHEE eshte 50 Hz , të gjitha pajisjet qe perdoren ne territorin shqiptar (por edhe ate European) perdorin frekuencen 50 Hz. Njekohesisht tolerance ndaj ketij parametri rekomandohet teknikisht të mos kaloj vlerat  $\pm 5\%$ .

Ajo qe eshte e logjikshme të kerkohet eshte toleranca e shprehur ne  $\pm x\%$ , dhe nuk ka arsye të kerkohet frekuenca 60-65 Hz, nga segmenti 45-65 Hz sepse i referohet sistemit amerikan kur keto makina shiten ne ate treg.

Ne keto kushte formulimi i kesaj pike dhe karakteristikat qe kerkohet nga 45 65 Hz eshte jo i sakte sepse parametrat e mirepercaktuar ne sistemin elektroenergjitik eshte me Frekuenca prej 50 Hz.

Pika Nr.6 OUTPUT :

6.1.Pika 6.1 e skedes teknike të paraqitur, konkretisht "FAKTORI I FUQISE" me Karakteristikat teknike " 1 " ka paqartesi dhe papajtueshmeri ndërmjet pikes se pare të shtojces 9 dhe pikës 6.1 të skedës teknike.

Konkretisht, ne piken e pare të shtojces 9 pershkruhet "UPS me fuqi 60 kVA / 48 KË". Teknikisht Faktori i fuqise sipas ketij pershkrimi eshte "0.8" dhe ne piken 6.1 të skedes teknike pershkruhet dhe kerkohet qe ky UPS 3 fazor të kete faktor fuqie "1"?!?

Ne kete rast specifikimi teknik per kete pike eshte i gabuar dhe eshte ne kundërshtim me veten.

Do iu ishim mirenjohes të na benit me dije dhe ne si OE se si e kerkoni Faktorin e fuqise: "0.8" apo "1", duke mos lene pa iu kujtuar se faktori i fuqise ne OUTPUT (dalje) eshte variabel i natyres se ngarkeses dhe anës konstruktive të makinerise (aktive/inductive/kapacitive) e cila nuk ekziston asnjehere të jetë 1, por të jetë sa me afer 1.

6.5. Tek Pershkrimi "TENSIONI T.H.D ME NGARKESE LINEARE TE VLERESUAR" me Karakteristika teknike " <2% " eshte e shprehur gabim dhe me mangesi per arsyet si me poshte:

Nqs flasim per termat Parametri teknik "Tensioni" dhe "T.H.D Niveli i harmonica" , kemi të bejme me dy pararnetra të ndryshem si rrjedhore dhe dy karakteristika të ndryshme ku e para tregon parameter teknik ne varesi të rrjetit të furnizimit me energji OSHEE dhe e dyta tregon cilesine e ngarkeses të shprehur me formen e harmonikës dhe oshilacionet e saj ne impiantin konsumator. Llogjikisht kemi të bejme me dy vlera!

Kerkojme të bejme korigjimin e nevojshem per parametrat e lartshenuara, të cilat paraqiten si nje i vetem duke cunuar dhe deformuar keshtu skeden teknike duke e here të pavlefshme.

6.8. Tek Pershkrimi "FREKUENCA E DREJTIMIT TE LIRE HZ" me Karakteristika teknike " +/- 0.01%".

Formuli i shprehur ne kete pike eshte eshte jo qartesisht i sakte dhe kerkojme sqarim teknik se cfare kerkohet nga ky parameter??!

Mbetemi ne pritje!

6.9. Tek skeda teknike pika 6.9, "te dhenat teknike të kerkuara" pershkrimi "EFIKASITETI" me Karakteristika teknike " 96% ".

Formulimi i shprehur ne kete pike eshte i pasakte dhe kontradiktor me veten . Kthehemi ne të njeten linje logjike qe kishim ne pikat e para të ankeses sone si OE ku theksojme se jemi dhe ne të njëjtën "linje diskriminimi" si me siper të vendosjes se nje vlere tashme shume fikse dhe percaktuese "96%" . Shikojme të nevojshem qe edhe ne kete karakteristike teknike të vendoset fjala perfshire, duke krijuar tashme nje interval dhe jo nje vlere fikse të percaktuar.

Pika Nr.7 BATTERI :

7.2 -Shikojme nje kriter akornamë percaktues tek kjo pike e skedes teknike konkretisht ankesen tone per kete pike e shtrojme ne kete forme:

Tek Pershkrimi "Sasia (cope)" me Karakteristika teknike " TBA" sepse ana sasiore nuk mund të shprehet me genna ose me numra. Ne fakt, nqs do ecim mbi parimet e sakta të nje skede teknike per baterine e nje UPS 3 fazor, ku parime të sakta nenkuptojme nje UPS qe të plotesoje kerkesat teknike dhe standartet per AK perlllogaritjet dhe nevojat e percaktimit nuk mund të bejme llogaritje per numrin e baterive qe duhet të kete UPS i nevojshem per Ju si AK, pasi nese percaktohet ky si kriter percaktues praktikisht keni percaktuar prodhuesin. Ne kerkesa të tjera per kete pike kalojme ne percaktimin e prodhuesit gje qe bie ne kundershtrim me Ligjin e LPP (Ligje të lartshenuara dhe lartcituara qartazi)

7.3 - Tek Pershkrimi "FUQJA E BATERIVE" me Karakteristika teknike " TBA". Formulimi i shprehur ne kete pike eshte eshte jo qartesisht i sakte dhe kerkojmë sqarim teknik se cfare kerkohet nga ky parameter sepse ana kapacitetit të baterise nuk mund të shprehet me germa, por me numra si parameter teknik.

I vetmi parameter i kerkuar nga ana Juaj si AK dhe percaktues duhet të jete Autonomia kohore qe ne rastin konkret kerkohet 20 min.

Edhe ketu duhet sqaruar perqindja e ngarkeses se ciles i referohet kjo autonomi.

Pika Nr.8 DISPLAY :

8.1 - Tek Pershkrimi "3.5" " me Karakteristika teknike " sipas pershkrimit të dhene:

Formulimi i shprehur ne kete pike eshte jo qartesisht i sakte, pasi ne varesi të prodhuesve të ndryshem DISPLAY mund të kete dimensione të ndryshme. E rendesishme duhet qe DISPLAY të paraqese të gjithë paramatrat teknik të kerkuar dhe të jene lehtesisht to lexueshem/mundesisht të aksesohet shume qarte menu e DISPLAY.

Arsyetojme, të mbeshtetur ne ligj dhe njohje shume të mira teknike se ky parameter duhet të kerkohet me diapazon dhe jo fiks, konkretisht : > se 3.5" .

Totalisht i paqarte, i padeshifrueshem teknikisht dhe dyshues per ne si OE se si mund të perkthehet kjo pas perfundimit të gares!

Pika Nr.9 BYPASS STATIC :

9.3 - Tek Pershkrimi "GAMA E FREKUENCES" " me Karakteristika teknike "47-53 ose 57-63" sipas pershkrimit të dhene.

Formulimi i shprehur është jo i drejte, sepse duke qene se enti i shperndarjes se energjise ka si parameter teknik frekuencen 50Hz me tolerance sipas prodhuesve, tipit të destinacionit, dhe cilesise se parametrave teknik optimal.

Ajo qe është e logjikshme të kerkohet është toleranca e shprehur ne  $\pm x\%$ , dhe nuk ka arsye të kerkohet frekuenca 47-53 Hz ose 57-63 Hz, sepse i referohet sistemit amerikan kur keto makina shiten ne ate treg.

Ne keto kushte formulimi i kesaj pike dhe karakteristikat qe kerkohet është jo i sakte sepse parametrat e mirepercaktuar ne sistemin elektroenergjitik është me Frekuenca prej 50 Hz.

Pika Nr.11 - MJEDISI :

11.1/2/3/4/5/6 Referuar ketyre zerave 1 1.1/2/3/4/5/6 , ne asnje nga pikat e saj nuk pershkrhet asnje e dhene teknike mbi kushtet e perdorimit dhe instalimit të pajisjes, faktor shume të rendesishem të cilet duhet të jene mire të percaktuar qe ndikojne ne tipologjiine e makinerise. Nuk ka asnje të dhene teknike dhe kjo pike 11 ndikon edhe ne piken 12 Mjedisi, ne raport me peshen, dimensionet dhe kushtet teknike të shfrytezimit, të cilat duhet të ishin mire specifikuar.

Pika Nr.12 - SPECIFIKIME FIZIKE :

12.1 - Tek Pershkrimi "PERMASAT LxDxH " me Karakteristika teknike "52x89x 131" sipas pershkrimit të dhene.

Ne keto permasa jane të perfshira edhe baterite?!!

Permasat nuk duhet te jene fikse, ndaj i kthehemi serish konceptit të `perfshirjes".

Maksimumi duhet të vendosen dimensionet maksimale të lejuara apo të ambjentit ne dispozicion perfshire ketu edhe dollapin e baterive.

12.2 - Tek Pershkrimi "PESHA (kg) " me Karakteristika teknike "202" sipas pershkrimit të dhene.

Pike tjeter diskriminuese ose percaktuese (qellimin e vertete të vendosjes se kesaj pike nuk e dime) është edhe vendosja e peshes me karakteristike teknike 202?

Ne kete është e perfshire dhe pesha e baterive??!!

Si ne shume pika të skedes teknike ne fjale, edhe tek pika konkrete "Pesha e baterive" jemi ne konceptin e peshes fikse, dhe rithemi serish se jemi ne konceptin e perjashtimit pasi pesha shprehet ne "peshe maksimale e lejuar".

Mendojme se ne peshen totale nuk është marre ne kosniderate pesha e baterive si dhe dollapit të tyre.

Duke qene se ne jemi njohes shume të mire të UPS-se mendojme se duhet të merren masa të sigurta per piken e instaliznit të dollapit të baterive, pasi pesha kgm2 i kalon shpesh here ato të llogaritura ne godine normale.

Ne keto kushte nese UPS-ja do të vendoset ose do të instalohet ne katin perdhe, me shume gjasa dollapi i baterive nuk do të jetë prane tij.

Si perfundim ne preventiv duhet të ishte edhe nje ze tjeter per kabllot që lidhen me bateritë me UPS.

Nqs do na duhet të mbledhim copezat e kesaj ankese, duke u, futur ne detajet e skedes teknike, është qartesisht e kutpueshme deshira per të specifikuar një UPS të kualitetit të larte, por menyra e specifikimit të cdo karakteristike teknike, ne gjykimin tone me disa gabime ne kerkesa dhe ne perkufizime e bejne të pamundur per Operatoret Ekonomike si Ne, të jene pjesemarres në këtë garë.



Nese ne fund të kesaj ankese do na duhet të bejme nje "historik " të atyre qe Ne cituam me !art, vemë re perdorim të shpeshte të "Ligji i Prokurimit Publik " nr 9643 date 20.11.2006, VKM Nr 914 date 29.12.2014, "Per miratimin e Rregullimit Publik ", ndrshuar me Ligjin Nr 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr 9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr 10170, date 22.10.2009, igjin nr 10 309 dates 22.07.2010, Ligjin nr 22/2012, Ligjin nr 131/2012 dhe Ligjin Nr 182/2014, konkretisht, Neni 1 (objekti dhe qëllimi i objektit qe prokurohet), Neni 20 (Mosdiskriminimi), Neni 23 (Specifikimet teknike per objektin qe prokurohet, specifikisht (mqs po konkludojme "gabime " ne skede teknike) , e gjejme veten të perjashtuar nga Neni 23 i ligjit të prokurimit, pasi ne skeden teknike të paraqitur fatkeqsisht nuk e gjejme veten të pacenuar ne piken 1 të nenit 23 ku kerkohet qe "specifikimet teknike te jene krijuar per prokurim të paaneshem e të hapur ndermjet të gjithë konkuresve ", nuk e gjejme veten të 'pacenuar" ne piken 2 të ketij neni ku kerkohet "specifikimet teknike duhet të mundesojne trajtim të njëjtë per të gjithë kandidatet dhe ofertuesit dhe të mos sherbejne si pengese per konkurimin e hapur per prokurimin publik ", aq me pak e gjejmë veten të pacenuar)-nese citojme piken 4 të ketij neni shkruhet (ashtu sikurse duhet te jete per hir të se veretetes) ku nder të tjera citon kjo pike e ligjit të LPP neni 23 "Në rast pershkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të pershkruajne ne menyre të sakte dhe neutrale qellimin e punimeve per njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rendesi per hartimin e ofertes. Nga pershkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dale jo vetem qëllimi i punës se kryer, por edhe kerkesat qe kane lidhje me kete punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Qe të garantohet krahasueshmeria e ofertave per kerkesat e objektit të kontrates per keto punime ose per funksionin e tyre, kerkesat e rendimentit dhe funksionit duhet te jene të sakta per t 'u dhene konkuresve dhe ofertuesve nje ide të qarte ne pergatitjen e ofertes. Ne pershkrimin e punimeve duhet të shenohen, kur eshte rasti, edhe specifikimet per furnizimin e mallrave apo sherbimeve, të pershtatshme per mjedisin " dhe per të permbledhur "historikun e përjashtimit le të themi " ne shumicen prej kriterëve të skedes teknike shikojme parametra dhe skede teknike të vendosura me vlere fikse, e duke meditar ne historikun e lartpemrur, nqs kjo skede ngelet e pandryshuar do iu rekomandonim të vendosni fjalën"ose ekuivalent " (sikur ligji e kerkon) ne menyre të tille të respektoni ate ne minimumin e tij të mundshem.

Per sa me siper cituam, kerkojme qe të rishikohet edhe një here skeda teknike per kete objekt prokurimi duke bere ndryshimet perkatese, jo sipas kerkesave Tona si OE, por duke ecur bashkarisht mbi logjiken teknike qe duhet të kete nje skede teknike per nje UPS 3.fazor.

Do iu ishim mirenjohes të shqyrtohen me shume kujdes cdo pike e cituar me lart, cdo detaj dhe të beni ballafaqimin me ligjet e prokurimit, qëllimin, objektin e prokurimit publik, te jeni të qartë dhe me deshiren e mire per cfare ju nevojitet..

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues nëpërmjet shkresës nr. 2237/1 prot., datë 25.10.2018, duke mos pranuar atë.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...]

*Bazuar ne ankesen tuaj me Nr. 2237 date 22.10.2018, per proceduren "Kerkese per propozim" me objekt: "Furnizim vendosje UPS 3 (tre) fazor per Reanimacionin e SUT", me Fond limit: 2,957,000 Leke pa TVSH, ju sqarojme si me poshte:*

*Grupi i shqyrtimit të ankeses pasi shqyrtoI kerkesen tuaj, nuk e mori ne konsiderate duke mos ndryshuar kriteret apo specifikimet teknike konkretisht per keto arsye.*

*Ne lidhje me ankesen tuaj, nga permbajtja e saj del se ankoheni per:*

*Ne lidhje me shtojcen 9, pika dy e kesaj shtojce shprehet ne kete forme : " UPS duhet të kete minimalisht karakteristikat e meposhtme".*

*Grupi i shqyrtimit të ankeses pasi shqyrtoj kete kerkese të OE nuk e mori ne konsiderate, sqarojme se UPS duhet të kete "minimalisht" karakteristikat e meposhtme nenkupton se UPS nuk duhet të kete parametra me të vogla (Ulëta) se parametrat e kerkuara ne skeden teknike të kerkuar nga AK.*

*Piken Nr. 5 - INPUT, Pika Nr.6 OUTPUT :, Pika Nr.7 BATTERI :, Pika Nr.8 DISPLAY :, Pika Nr.9 BYPASS STATIC :, Pika Nr.II - MJEDISI :, Pika Nr.12 SPECIFIKIME teknike,*

*Ne lidhje me keto pika të ankeses qe kane të bejne me specifikimet teknike:*

*AK per të plotesuar nevojën per vendosjen e UPS, studioi disa firma prestigjoze të prodhimit të UPS dhe vendosi të hartojë keto specifikime teknike duke respektuar ligjin e prokurimit publik, duke pershkruar sakt dhe ne menyre të plote të gjithë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim të paanshem e të hapur per të gjithë kandidatet ofertues. Ne kete procedure prokurimi nuk jane kerkuar produktet me emer apo marke por jemi referuar standarteve kombetare dhe nderkombetare. Grupi i Punes qe hartoi Specifikimet Teknike eshte i bindur qe keto specifikime mund ti plotesoi cdo Operator Ekonomik qe Operon ne treg, edhe nese nuk jane prodhues mund të sigurojne mallin e kerkuar nga prodhues të tjere brenda ose jasht vendit, ose nga distributor të autorizuar prej tyre. Pasi ankesa juaj u shqyrtua me kujdes, KSHA vendosi: - të mos e marrë parasysh Ankesen, duke mbetur keshtu nje gare e hapur per të gjithë OE.*

*Per sa me siper, grupi qe ka per detyre të shqyrtojë ankesen i verifikojë pretendimet e OE dhe vendosi ne baze të LPP dhe VKM nr.914 date 29.12.2014 i ndryshuar..[...]*

*Si përfundim, vlerësojmë se ankesa juaj të mos merret parasysh.*

II.4. Në datën 30.10.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor.

Në lidhje me kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor operatori ekonomik argumenton si poshtë vijon:

[...]

Pasi, AK Spitali Universitar i Traumes ktheu pergjigje duke mos marrë ne konsiderate asnje nga pikat e ankimit. Me ane të pergjigjes se kthyer nga autoriteti kontraktor me ane të shkreses Nr 2237/1Prot, shkrese e cila na ben me dije se pas AK ka arritur ne perfundimin se, asnje nga pikat e ankeses sone të mos merret parasysh.

I vetmi sqarim qe AK ka bere eshte per termin e perdorur "minimalisht", ku shprehet se : UPS nuk duhet të kete parametra me të vogla (Uleta) se parametrat e kerkuar ne skeden teknike nga AK"

Duke u bazuar tashme tek pergjigjia e shkreses se lartepemendur, "Lenda: Kthim pergjigjigie" me Nr 2237/1Prot, nga AK Spitali Universitar i Traumes, i cili i ka dhene pergjigje fjales minimalisht, duke kthyer pergjigje indirekt per disa nga pikat e ngritura ne ankesen tone per Ak Spitali i Traumes (ankese e bere nga OE "A BI ESSE" shpk me date 22.10.2018, bashkengjitur ketij formulari ankese)

11.1. Me Konceptin e fjales minimalisht, kemi marre pergjigje per :

Pika Nr 5 e skedes teknike " RRYMA E TENSIONIT" me karakteristike teknike (-15)% (+20%)" duke marre ne konsiderate se Rryma e tensionit per UPS do te jete minimalisht 15)% (+20%)"

Pika Nr 5.4 e skedes teknike "GAMA E TENSIONIT (64% ngarkesa) " me Karakteristika teknike "(-45)% (+20%), marrim ne konsiderate se ne keto kushte parametrat per kete pike do të jene minimalisht "(-45)% (+20%).

Pika Nr. 5.7 e skedes teknike "GAMA E FREKUENCES PER OPERIM ONLINE" jepet Karakteristika teknike "( 45 65 Hz)", ne baze të pergjigjes nga AK Spitali Universitar i Traumes, "GAMA E FREKUENCES PER OPERIM ONLINE" do te jete minimalisht "( 45 65 Hz)".

- Pika Nr. 6.5 e skedes teknike "TENSIONI T.H.D ME NGARKESE LINEARE TE VLERESUAR" me Karakteristika teknike " <2%, "TENSIONI T.H.D ME NGARKESE LINEARE TE VLERESUAR" do të jete minimalisht " <2%.

- Pika 6.8 e skedes teknike "FREKUENCA E DREJTIMIT TE LIRE HZ" me Karakteristika teknike " +/- 0.01 %, "FREKUENCA E DREJTIMIT TE LIRE HZ" do të jete minimalisht 0.01%.

- Pika 6.9 e skedes teknike "EFIKASITETI" me Karakteristika teknike " 96% ", EFIKASITETI do te jete minimalisht 96%.

Pika 9.3 e skedes teknike "GAMA E FREKUENCES" " me Karakteristika teknike "47-53 ose 57-63, "GAMA E FREKUENCES" do te jete minimalisht "47-53 ose 57-63.

- Pika 12.1 e skedes teknike "PERMASAT LxDxH " me Karakteristika teknike "52x89x131 ", ne kuptimin e termit minimalisht, "PERMASAT LxDxH " do të jene minimalisht "52x89x131".

Pika 12.2 e skedes teknike "PESHA (kg) " me Karakteristika teknike "202", ne kuptimin e termit minimalisht do të jete minimalisht 202 kg.

E ngreme ankesen tone per pikat e poshteshenuara të skedes teknike të cilat jane të shprehura gabim si dhe ne kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik "Ligji i Prokurimit Publik", nr 9643 date 20.11.2006, Neni 1 (Objekti dhe Qellimi) :[...]

## 11.2."Pika-6 OUTPUT"

### 11.2.1"6.1"- "FAKTORI I FUQISE"

Kjo pike e skedes teknike paraqitet nga Autoriteti Kontraktor me dy parametra të ndryshem: Konkretisht :

- Shtojca 9, paraqitur nga AK pika " pare" ka vene kriter qe "UPS (cope 1), 3 Fazor me hyrje 400 V, 50 HZ, me fuqi 60KVA/48KË dhe me dalje 380V,50Hz, Sinusoidal, të jete online dhe të kete 3 hyrje dhe 3 dalje, me pavaresi kohore 20 min pa shkeputje dhe të certifikuar me sistemin CE." (ne kete pike faktori i fuqise kerkohet të jete  $48K\ddot{E}/60KVA=0.8$ )
- Ne skeden teknike to paraqitur nga AK , Pika 6.1 e saj percakton qe Faktori i Fuqise të jete 1. (ne kete pike faktori I fuqise kerkohet to jete 1)

Ne kete pike, Skeda teknike bie ne kundërshtim me veten!

Nuk mund to jepen dy vlera to ndryshme per të njejtin parameter.

Nje mosperuthje tjeter e parametrave teknik qe perforcon ate cfare po themi me lart eshte ndermjet Pikes

5.9 "Faktori i Fuqise INPUT" i cili eshte dhene me vleren 0.99 dhe Faktori i fuqise OUTPUT pika 6.1 e skedes teknike eshte kerkuar to jete 1.

Faktori i fuqise OUTPUT qe ne rastin konkret eshte kerkuar të jete 1 nuk mund të jete me i madh se Faktori i Fuqise INPUT, ne rastin konkret kerkuar nga AK to jete 0.99.

VO: Faktori i Fuqise OUTPUT eshte gjithmone me i vogel se faktori i fuqise INPUT.

Ne kete pike skeda teknike bie poshte pasi paramterat e larteshenuara, të kerkuara nga AK per kete skede teknike jane percaktuar ne menyre jo korrekte.


Eshte shume e qarte kundërshtia qe ka skeda teknike me veten e saj. Teknikisht i verifikueshem.

Per sa me siper shprehem, kerkojme pezullimin e kesaj procedure prokurimi pasi parametrat e skedes teknike jane të percaktuara gabim, gje qe le vend per ekuivok per objektin e prokurimit qe do të zhvillohet, si dhe bie ne kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik "Ligji i Prokurimit Publik", nr 9643 date 20.11.2006, Neni 23 , Specifikimet Teknike, Pika 1, "Specifikimet teknike, qe percakojne karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do të prokurohen, duhet të pergatiten per të pershkruar sa më sakte dhe ne menyre të plote të gjithe objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurim të paaneshen: e të hapur ndermjet të gjithe kandidateve e ofertuesve. ".

### 11.3. "Pika 7- BATTERY"

"Pika 7.2- Sasia (cope); Te dhena teknike të kerkuara- TBA" dhe 11.3.2 "Pika 7.3-Fuqia e baterive; Te dhena teknike- TBA" Ne shtojcen të nr 9, të paraqitur nga AK, ne pershkrimin fillestar të UPS-se specifkohet autonomia, konkretisht "me pavaresi kohore 20 min pa shkeputie". Ky percaktim teknik eshte i pamiaftueshem dhe le vend per subjektivizem nese nuk percaktohet fuqia ne të cilen llogaritet kjo autonomi. Kerkojme të shprehet saktesisht ngarkesa per të cilen duhet llogaritur autonomia e kerkuar prej 20 min, pasi vetem koha ne min pa ngarkesen ne të cilen duhet llogaritur eshte parameter i cunguar dhe le vend per subjektivizem.

II.5.Në datën 12.11.2018, nëpërmjet shkresës me nr.2405/1 prot., datë 09.11.2018, protokolluar me tonën nr. 1660/2prot., datë 12.11.2018, si dhe shkresës nr. 2405/2 prot., datë 09.11.2018, protokolluar me tonën 1660/3 prpt., datë 12.11.2018 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "A BI ESSE" sh.p.k.



pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "ABI ESSE" sh.p.k për modifikimin e specifikimeve teknike për UPS-in me argumentat se "Referuar specifikimeve teknike (Shtojca 9) kerkohet UPS (cope 1), 3 fazor me hyrje 400 V, 50 Hz me fuqi 60KVA/48KË dhe me dalje 380 V, 50 Hz, Sinusoidal, të jetë online dhe të kete 3 Hyrje dhe 3 dalje me pavaresi kohore 20 minuta pa shkeputje dhe certifikuar me sistemin CE. Nese citojme shtojcen 9, pika dy e kesaj shtojce shprehet ne kete forme : " UPS duhet të kete minimalisht karakteristikat e meposhtme" Paqartesia jone si OE fillon qe ne kete pike të ketij objekti tenderimi, konkretisht per kuptimin e fjales "minimalisht" pasi kuptimin i saj eshte mjaft i gjere.

Pyetja konkrete eshte se "UPS 3 fazor qe tenderohet ne kete objekt prokurimi ka dhe karakteristika të tjera? Ne cfare koncepti eshte shtruar kjo fjali, pasi nese lexojme fjaline " UPS duhet të kete minimalisht karakteristikat e meposhtme" nenkuptohet qe mund të kete edhe karakteristika të tjera, e nese ka dhe karakteristika të tjera i bie qe nuk kemi të bejme me të njejtin UPS 3 fazor pasi nje karakteristike ndryshe nga keto qe jane publikuar ndryshon objektin e e prokurimit.

Ju lutemi të na sqaroni koceptin e lartpermendur.

Ne kërkesat teknike të pershkruara minimale ka disa paqartesi dhe formulime qe mendojme se jane shprehur keq konceptin inxhinierik, teknik si vijon

➤ Pika Nr.5 INPUT :


5.3 Tek Pershkrimi "RRYMA E TENSIONIT" me Karakteristika teknike " (- 15)% (+20%)".

Termi i shprehur ne piken "5.3" të skedes eshte i gabuar dhe ne kundeshitim me Ligjin e Prokurimit Publik" nr 9643 date 20.1 1.2006. VKM Nr 914 date 29.12.2014, "Per miratimin e Rregullave Publik", ndryshuar me Ligjin Nr 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr 9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr 10170, date 22.10.2009, Ligjin nr 10 309 date 22.07.2010, Ligjin nr 22/2012, Ligjin nr 131/2012 dhe Ligjin Nr 182/2014, konkretisht Neni 23, "Specifikimet teknike" ku qartesisht shprehet se:

Pika 1- Specifikimet teknike, qe percakojne karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do të prokurohen , duhet të pergatiten per të pershkruar sa me sakte dhe ne menyre të plote të gjithë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurim të paaneshern e të hapur ndërmjet të gjithë kandidateve e ofertuesve.

Pika 2- Specifikimet teknike duhet të mundesojne trajtim të njejte per të gjithë kandidatet dhe ofertuesit dhe të mos sherbejne si pengese per konkurimin e hapur per prokurimin publik.

Pika 3- Specifikimet teknike duhet të pershkruajne qarte kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:[...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:



III.1.1. Në shtojcën 9 ‘Specifikime Teknike’ të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

### Public Health Sector SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike duhet te permbushin standartet e kerkuara minimale si me poshte:

- UPS (cope 1), 3 fazor me hyrje 400V, 50 HZ, me fuqi 60KVA/48KË dhe me dalje 380V, 50Hz, Sinusoidal, te jete online dhe te kete 3 hyrje dhe 3 dalje, me pavaresi kohore 20 minuta pa shkeputje dhe te certifikuar me sistemin CE.
- UPS duhet te kete minimalisht karakteristikat e meposhtme:

UPS 3-3 60 kVA

No.	Pershkrimi	Te dhenat teknike te kerkuara	Te dhenat e ofruara nga
-----	------------	-------------------------------	-------------------------

			ofertuesit
1	Prodhuesi		
2	Tipi		
3	Modeli		
4	Vendi i origjines		
5	<b>INPUT</b>		
5.1	Numri i fazave	3Ph + N + PE	
5.2	Tensioni nominale	380V / 400V / 415V	
5.3	Rryma e tensionit	(-15)% (+20)%	
5.4	Gama e tensionit (% 64 ngarkesa)	(-45)% (+20)%	
5.5	Rryma e tensionit (% 42 ngarkesa)		
5.6	Frekuenca nominale (Hz)	50 ose 60	
5.7	Gama e frekuencës për operimin online	45-65Hz	
5.8	Futja aktuale THD	≤4%	
5.9	Faktori i Fuqisë Input	0,99	
6	<b>OUTPUT</b>		
6.1	Faktori i fuqisë	1	
6.2	Numri i fazave	3Ph + N + PE	
6.3	Tensioni (faza 3ph në fazë)	380V / 400V / 415V	
6.4	Rregullimi i tensionit statik në% 100 Ngarkesë lineare (on line dhe në modalitetin e baterisë)	<1%	
6.5	Tensioni THD me ngarkesën lineare të vlerësuar	<2%	
	Rregullimi Dinamik i Tensionit në Mënyra Online (0- 100% Ngarkese me Hap Linear )	±5% rms <20ms	
	Tensioni THD me	<5%	

	<i>ngarkesën jo lineare të vlerësuar</i>		
6.6	<i>Faktori i kreshtës</i>	3: 1	
6.7	<i>Frekuenca (Hz)</i>	50 ose 60	
6.8	<i>Frekuenca e Drejtimit të Lirë (Hz)</i>	± 0.01%	
6.9	<i>Mbingarkesë</i>	125% për 10 minuta dhe 150% për 1 minutë	
	<i>Efikasiteti</i>	96%	
	<i>Efikasiteti ECOMODE</i>	98,5%	
7	<b>BATTERY</b>		
7.1	<i>Lloji</i>	<i>Bateri me Acid, dhe me vete mirembajtje</i>	
7.2	<i>Sasia (copë)</i>	TBA	
7.3	<i>Fuqia e Baterive</i>	TBA	
7.4	<i>Mbrojtja e baterisë</i>	<i>Mbrojtja e shkarkimit të thellë me Auto Cut off dhe me kontroll te temperatures gjate karikimit.</i>	
7.5	<i>Standardi i testimit të baterisë</i>	<i>(automatik dhe manual)</i>	
8	<b>DISPLAY</b>		
8.1	<i>3.5 "Ekran me prekje grafike</i>	<p><i>Tensioni i Input (Rectifier) (Vac, në fazë); Aktual (AAC, sipas fazës); Frekuenca (Hz) Prodhimi (inverter)</i></p> <p><i>Tensioni (Vac, në fazë); Aktual (AAC, sipas fazës); Frekuenca (Hz); Ngarkesa (% , për fazë); Fuqia (kVA, per faza); Fuqia (kË, për fazë); Faktori i ngarkesës së ngarkesës (në fazë)</i></p> <p><i>Tensioni i anashkalimit (Vac, në fazë); Frekuenca (Hz)</i></p> <p><i>Bateri</i></p> <p><i>Tensioni i brezit të DC (± Vdc); Tensioni i baterisë (± Vdc); Rryma e Ngarkesës / Shkarkimit (± Adc); Temperatura (° C); Koha e mbetur e rezervës (minutë)</i></p> <p><i>Kontrollet e Inkorporuara Inverter /</i></p>	



		<i>Bypass-Eco Mode Prioritet; Rectifier / Inverter / Bypass Aktivizo ose çaktivizo</i>	
		<i>Përshatjet nga paneli i panelit të alarmit dhe tastit; Shfaq Brigtness; Funkcionet e releve; Prioriteti (Online ose ECO Mode); Date &amp; Time; Gjuhe; Test Battery</i>	
9	<b>BYPAS STATIC</b>		
9.1	<i>Numri i fazave</i>	<i>3Ph + N + PE</i>	
9.2	<i>Gama e tensionit për operimin e anashkalimit (V)</i>	<i>380V / 400V / 415V -15% ± 10%</i>	
9.3	<i>Gama e frekuencës për operacionin e anashkalimit (Hz)</i>	<i>47-53 ose 57-63 (konfigurueshëm)</i>	
10	<b>KOMUNIKIMI</b>		
10.1	<i>Ndërfaqja (Portet e Komunikimit)</i>	<i>RS232, RS485 (ModBus)</i>	
10.2	<i>Sinjalet e kontaktit të transmetimit (i rregullueshëm)</i>	<i>4cope Rele te konfiguruar për ; "Alarm te Përgjithshëm", "Dështimi i Inputit", "Dështimi i Baterisë", "Dështimi i Produktit", "Bypass Active", "Mbingarkesa e Prodhimit" a- "Temperatura e lartë" Sinjalet e kontaktit të thatë</i>	
10.3	<i>Të tjerët</i>	<i>EPO, Interface Generator</i>	
11	<b>MJEDISI</b>		
11.1	<i>Gama e Temperaturës së Ruajtjes (° C)</i>		
11.2	<i>Gama e Temperaturës së Punës (° C)</i>		
11.3	<i>Gama e Lagështisë relative</i>		
11.4	<i>Lartësia maksimale pa ulje (m)</i>		
11.5	<i>Niveli i mbrojtjes</i>		
11.6	<i>Niveli i zhurmës nga 1m (dBA)</i>		

12	<b>SPECIFIKIMET FIZIKE</b>		
12.1	Përmasat LxDxH (cm)	52x89x131	
12.2	Pesha (kg)	202	
13	<b>STANDARDET</b>		
13.1	Standardet	EN 62040-1 (Siguria), EN 62040-2 (EMC), EN 62040-3 (VFI-SS-111)	

*Periudha e garancise duhet te jete minimalisht per 12 muaj dhe Operatori ekonomik do te mbaje pergjegjesi jo vetem per UPS (ne rast mosfunksionimi) por edhe per demin e shkaktuar ne paisjet e SUT te cilat mund te demtohen si pasoje e mosfunksionimit te UPS te kerkuar.*

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

III.1.3. Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 3 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

### Public Health Sector

III.1.4. Në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, 2 dhe 3, parashikohet se :

*“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor,*

*duke iu referuar:*

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përpuethshmëri me objektin e kontratës. K.P.P thekson se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma "b" dhe "c" e LPP-së) janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se specifikimet teknike duhet të jenë sa më gjithpërfshirëse, por pa cënuar thelbin e garancisë mbi cilësinë e shërbimit/punës/mallit që autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë.

### Public Health Sector

III.1.5. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me shtojcën 9 pika 2 e kësaj shtojce e përcaktuar nga autoriteti kontraktor sqarohet se: "[...]UPS duhet të ketë "minimalisht" karakteristikat e mëposhtme nënkupton se UPS nuk duhet të ketë parametra më të vogla (Ulëta) se parametrat e kërkuara në skeden teknike të kërkuar nga AK. KPP gjykon se sqarimi i bërë nga autoriteti kontraktor pa asnjë referencë ligjore nuk është bindës. Akoma më tej Komisioni bazuar edhe në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, nga verifikimet e kryera sipas specifikimeve dhe parametrave të përcaktuara në dokumentat e tenderit për UPS, konstatohet se në specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor shprehet "UPS duhet të ketë minimalisht karakteristikat e mëposhtme". Në këtë kuptim referuar specifikimeve teknike të publikuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 9 të DT objekt shqyrtimi shprehja UPS duhet të ketë "minimalisht" karakteristikat e mëposhtme bie ndesh me kriteret e shprehura në diapazon në një interval të caktuar ku ka vlerë minimale dhe maksimale. Gjithashtu shprehja "minimalisht" kur një karakteristikë kërkohet në mënyrë të vecantë të ketë një vlerë fikse as më të madhe dhe as më të vogël, por një vlerë fikse. Sa më sipër KPP gjykon se pretendimi i ankimesit lidhur me konceptin e

lantëpërmendur “*minimalisht*” qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të shprehet në mënyrë fikse duke shtuar vlerat e tolerancës. Përsa më sipër Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin e vendosur në përputhje me kërkesat e ankimuesit.

III.1.6. Lidhur me pretendimin për specifikimin tjetër të vendosur me arsyetimin se “*Ne kërkesat teknike të pershkruara minimale ka disa paqartesi dhe formulime qe mendojme se jane shprehur keq konceptin inxhinierik, teknik si vijon*

➤ *Pika Nr.5 INPUT : 5.3 Tek Pershkrirni "RRYMA E TENSIONIT" me Karakteristika teknike " (-15)% (+20%)". Termi i shprehur ne piken "5.3" të skedes eshte i gabuar dhe ne kundeshitim me Ligjin e Prokurimit Publik" nr 9643 date 20.1 1.2006. VKM Nr 914 date 29.12.2014, "Per miratimin e Rregullave Publik", " Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, referuar kthim përgjigjes së autoritetit cili sqaron se: UPS duhet të kete "minimalisht" karakteristikat e meposhtme nenkupton se UPS nuk duhet të kete parametra me të vogla (Ulëta) se parametrat e kerkuara ne skeden teknike të kerkuar nga AK. Piken Nr. 5" [...]” Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rregullojë përshkrimin e karakteristikave. Lidhur me konceptin teknik “Rrymë elektrike” dhe “Tension” sqarojme se janë 2 koncepte të ndryshme. Autoriteti kontraktor të marrë masa për të rregulluar përshkrimin e karakteristikave sipas gjuhës teknike në fushën e instalimeve elektrike. Në lidhje me pikën 5.3 duhet që autoriteti kontraktor të shprehet me parametrat nga vlera minimale deri në vlerën maksimale që nënkupton dhe heqjen e kllapave. Përsa më sipër Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin e vendosur në përputhje me kërkesat e ankimuesit.*

III.1.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e specifikimit tjetër të vendosur me arsyetimin se “ *5.4. Nese kalojme tek kjo pike e skedes teknike Pershkrimi "GAMA E TENSIONIT (64% ngarkesa) " me Karakteristika teknike "(-45)% (+20%)”jemi serish ne të njëjtën "linje diskriminimi" si me siper të vendosjes se nje vlere fikse dhe jo të nje intervali pasi të dhenat teknike të kerkuara "(45)% (+20%)", nuk perbejne interval të nje karakteristike teknike por të nje "intervali percaktues" pasi nqs flasim per të dhena teknike jemi ne kushtet e tolerances ose me sakte intervali qe nuk ndryshon thelbi dhe nuk devijojrne nga qellimi por vetem sa zgjerohet diapazoni i OE pjesemarres pa ndryshuar qellimin dhe objektin e prokurimit. Nqs do na duhet të ecim ne nje linje me ligjin e prokurimit ky parameter duhet shprehur ne kuptimin e nje inetervali, qe do të thote te jemi ne linjen e fjalës "perfshire" e cila e shprehur teknikisht shprehet ne vlerat e mosbarazimit "<".*

*Kushti i shprehur ne piken 5.4 ka formulim dhe kerkese jo të sakte kerkohet nje pajisje qe duhet të funksionojë ne sistem 3 Fazor me tension 400V dhe jo the tolerance teknike 45% ne vleren 220 V per të cilen detyrimi ligjor i OSHEE sipas ligjit Nr 43/2015 me nenet perkatese të tij, konkretisht, neni 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe neni 94, 96 " Per Sektorin e Energjise Elektrike", dhe referuar kontrates tip, pika 15.5, ku shprehet qarte se per kryeqytetin eshte detyrim të furnizojë energjine me cilesine e*

*tensionit ne masen  $\pm 5\%$ .*” Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, gjykon se autoriteti kontraktor në lidhje me pikën 5.4 “Gama e tensionit” duhet të veprojë sic kemi sqaruar në lidhje me pikën 5 dhe pikën 5.3. të specifikimeve teknike. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të hequr kllapat e vendosura në këto vlera duke u shprehur në vlera minimale deri në vlera maksimale. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor të bëjë modifikimin sa më sipër.

III.1.8. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e specifikimit tjetër të vendosur me arsyetimin se “5.7. Ne piken 5.7 të skedes teknike, konkretisht "GAMA E FREKUENCES PER OPERIM ONLINE" jepet Karakteristika teknike "( 45 65 Hz)". Duke qene se sistem i furnizimit me energji ne sistemit e shperndarjes të entit OSHEE eshte 50 Hz , të gjitha pajisjet qe perdoren ne territorin shqiptar (por edhe ate European) perdorin frekuencen 50 Hz. Njekohesisht tolerance ndaj ketij parametri rekomandohet teknikisht të mos kaloj vlerat  $\pm 5\%$ .

*Ajo qe eshte e logjikhme të kerkohet eshte toleranca e shprehur ne  $\pm x\%$ , dhe nuk ka arsye të kerkohet frekuenca 60-65 Hz, nga segmenti 45-65 Hz sepse i referohet sistemit amerikan kur keto makina shiten ne ate treg.*

*Ne keto kushte formulimi i kesaj pike dhe karakteristikat qe kerkohet nga 45 65 Hz eshte jo i sakte sepse parametrat e mirepercaktuar ne sistemin elektroenergjitik eshte me Frekuenca prej 50 Hz.”*

Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit gjykon se, autoriteti kontraktor për këtë pikë PIKA 5.7 “Gama e frekuencës për operim online” duhet të vendosi frekuencën nominale 50HZ në përputhje me standartin shqiptar të furnizimit me energji, ndërsa për pjesa të përket gamës së frekuencës të shpehet në vlera tolerance. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor të bëjë modifikimin sa më sipër.

III.1.9. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e specifikimit tjetër të vendosur me arsyetimin se “Pika Nr.6 OUTPUT : 6.1.Pika 6.1 e skedes teknike të paraqitur, konkretisht "FAKTORI I FUQISE" me Karakteristikat teknike " 1 " ka paqartesi dhe papajtueshmeri ndërmjet pikes se pare të shtojces 9 dhe pikës 6.1 të skedës teknike.

*Konkretisht, ne piken e pare të shtojces 9 pershkruhet "UPS me fuqi 60 kVA / 48 KË". Teknikisht Faktori i fuqise sipas ketij pershkrimi eshte "0.8" dhe ne piken 6.1 të skedes teknike pershkruhet dhe kerkohet qe ky UPS 3 fazor të kete faktor fuqie "1"?!!*

*Ne kete rast specifikimi teknik per kete pike eshte i gabuar dhe eshte ne kundërshtim me veten.*

*Do iu ishim mirenjohes të na benit me dije dhe ne si OE se si e kerkoni Faktorin e fuqise: "0.8" apo "1", duke mos lene pa iu kujtuar se faktori i fuqise ne OUTPUT (dalje) eshte variabel i natyres se ngarkeses dhe anës konstruktive të makinerise (aktive/inductive/kapacitive) e cila nuk ekziston asnjehere të jetë 1, por të jetë sa me afer 1.*

6.5. Tek Pershkrimi "TENSIONI T.H.D ME NGARKESE LINEARE TE VLERESUAR" me Karakteristika teknike "  $<2\%$  " eshte e shprehur gabim dhe me mangesi per arsyet si me poshte:

*Nqs flasim per termat Parametri teknik "Tensioni" dhe "T.H.D Niveli i harmonica" , kemi të bejme me dy pararnetra të ndryshem si rrjedhore dhe dy karakteristika të ndryshme ku e para tregon parameter teknik ne varesi të rrjetit të furnizimit me energji OSHEE dhe e dyta tregon cilesine e ngarkeses të shprehur me formen e harmonikës dhe oshilacionet e saj ne impiantin konsumator. Llogjikisht kemi të bejme me dy vlera!*

*Kerkojme të bejme korigjimin e nevojshem per parametrat e lartshenuara, të cilat paraqiten si nje i vetem duke cunuar dhe deformuar keshtu skeden teknike duke e here të pavlefshme.*

*6.8. Tek Pershkrimi "FREKUENCA E DREJTIMIT TE LIRE HZ" me Karakteristika teknike " +/- 0.01%".*

*Formuli i shprehur ne kete pike eshte eshte jo qartesisht i sakte dhe kerkojme sqarim teknik se cfare kerkohet nga ky parameter??!!*

*Mbetemi ne pritje!*

*6.9. Tek skeda teknike pika 6.9, "te dhenat teknike të kerkuara" pershkrimi "EFIKASITETI" me Karakteristika teknike " 96% ".*

*Formulimi i shprehur ne kete pike eshte i pasakte dhe kontradiktor me veten . Kthehemi ne të njeten linje logjike qe kishim ne pikat e para të ankeses sone si OE ku theksojme se jemi dhe ne të njëjtën "linje diskriminimi" si me siper të vendosjes se nje vlere tashme shume fikse dhe percaktuese "96%" .*

*Shikojme të nevojshem qe edhe ne kete karakteristike teknike të vendoset fjala perfshire, duke krijuar tashme nje interval dhe jo nje vlere fikse të percaktuar. Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni gjykon se, në lidhje me pikën 6.1 "Faktori i Fuqisë", referuar specifikimit të UPS-it me fuqi 60 KVA/48KË duhet ndryshuar në përputhje me kërkesën e UPS-it 60KVA/48KË. Akoma më tej në lidhje me pikën 6.5 "Tensioni THD me ngarkesën lineare të vlerësuar" autoriteti kontraktor duhet të bëjë saktësimin e nevojshëm për këtë parametër. Në lidhje me pikën 6.8. "Frekuenca e Drejtimit të Lirë (Hz) " me të dhënat teknike te ëkërkuar +/-0.01% duhet të saktësohet kjo karakteristike, ndërsa në lidhje me pikën 6.9 "Efikasiteti" KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të shprehet në vlera tolerance "nga" në "deri", ose +/-.*

*III.1.10. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e specifikimit tjetër të vendosur me arsyetimin se "Pika Nr.7 BATTERI : 7.2 -Shikojme nje kriter akoma më percaktues tek kjo pike e skedes teknike konkretisht ankesen tone per kete pike e shtrojme ne kete forme:*

*Tek Pershkrimi "Sasia (cope)" me Karakteristika teknike " TBA" sepse ana sasiore nuk mund të shprehet me germa ose me nurnra. Ne fakt, nqs do ecim mbi parimet e sakta të nje skede teknike per baterine e nje UPS 3 fazor, ku parime të sakta nenkuptojme nje UPS qe të plotesoje kerkesat teknike dhe standartet per AK perlllogaritjet dhe nevojat e percaktimit nuk mund të bejme llogaritje per numrin e baterive qe duhet të kete UPS i nevojshem per Ju si AK, pasi nese percaktohet ky si kriter percaktues praktikisht keni percaktuar prodhuesin. Ne kerkesa të tjera per kete pike kalojme ne percaktimin e prodhuesit gjë qe bie ne kundërshtim me Ligjin e LPP (Ligje të lartshenuara dhe lartcituara qartazi)*

7.3 - Tek Pershkrimi "FUQJA E BATERIVE" me Karakteristika teknike " TBA". Formulimi i shprehur ne kete pike eshte eshte jo qartesisht i sakte dhe kerkojmë sqarim teknik se cfare kerkohet nga ky parameter sepse ana kapacitetit të baterise nuk mund të shprehet me germa, por me numra si parameter teknik.

I vetmi parameter i kerkuar nga ana Juaj si AK dhe percaktues duhet të jete Autonomia kohore qe ne rastin konkret kerkohet 20 min.

Edhe ketu duhet sqaruar perqindja e ngarkeses se ciles i referohet kjo autonomi." KPP bazuar në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni gjykon se këto kërkesa janë ezauruar nga autoriteti kontraktor duke përcaktuar specifikimin teknik "20 minuta" , por nga ana tjetër autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në çfarë lloj ngarkese duhen 20 minuta pavarisi kohore. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor të bëjë saktësimin përkatës në lidhje me këtë pikë.

III.1.11. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e specifikimit tjetër të vendosur me arsyetimin se "Pika Nr.8 DISPLAY :

8.1 - Tek Pershkrimi "3.5" " me Karakteristika teknike " sipas pershkrimit të dhene:

Formulimi i shprehur ne kete pike eshte jo qartesisht i sakte, pasi ne varesi të prodhuesve të ndryshem DISPLAY mund të kete dimensione të ndryshme. E rendesishme duhet qe DISPLAY të paraqese të gjithë paramatrat teknik të kerkuar dhe të jene lehtesisht to lexueshem/mundesisht të aksesohet shume qarte menu e DISPLAY.

Arsyetojme, të mbeshtetur ne ligj dhe njohje shume të mira teknike se ky parameter duhet të kerkohet me diapazon dhe jo fiks, konkretisht : > se 3.5" .

Totalisht i paqarte, i padeshifrueshem teknikisht dhe dyshues per ne si OE se si mund të perkthehet kjo pas perfundimit të gares!" KPP bazuar në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni gjykon se, autoriteti kontraktor në lidhje me madhësinë e ekranit duhet të shprehet "jo më e vogël se 3.5 inch", ku të paraqiten në mënyrë grafike stutuset e kërkuara nga ky i fundit për funksionimin e UPS-it. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor të bëjë modifikimin sa më sipër arsyetuar.

III.1.12. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e specifikimit tjetër të vendosur me arsyetimin se "Pika Nr.9 BYPASS STATIC :

9.3 - Tek Pershkrimi "GAMA E FREKUENCES" " me Karakteristika teknike "47-53 ose 57-63" sipas pershkrimit të dhene.

Formulimi i shprehur eshte jo i drejte, sepse duke gene se enti i shperndarjes se energjise ka si parameter teknik frekuencen 50Hz me tolerance sipas prodhuesve, tipit të destinacionit, dhe cilesise se parametrave teknik optimal.

Ajo qe eshte e logjikshme të kerkohet eshte toleranca e shprehur ne  $\pm x\%$ , dhe nuk ka arsye të kerkohet frekuenca 47-53 Hz ose 57-63 Hz, sepse i referohet sistemit amerikan kur keto makina shiten ne ate treg.

Ne keto kushte formulimi i kesaj pike dhe karakteristikat qe kerkohet eshte jo i sakte sepse parametrat e mirepercaktuar ne sistemin elektroenergjitik eshte me Frekuenca prej 50 Hz." KPP bazuar në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni gjykon se

autoriteti kontraktor duhet ti përmbahet standartit shqiptar me furnizim me energji elektrike. Pra në përcaktimin e këtij specifikimi teknik autoriteti kontraktor duhet të marrë masat e nevojshme për përcaktimin e tij konform parametrin (standartit) të përcaktuar nga enti i shpërndarjes së energjisë në Republikën e Shqipërisë. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor të kryejë modifikimin e specifikimit teknik sa më sipër.

III.1.13. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e specifikimit tjetër të vendosur me arsyetimin se *“Pika Nr.11 - MJEDISI :*

*11.1/2/3/4/5/6 Referuar ketyre zerave 1 1.1/2/3/4/5/6 , ne asnje nga pikat e saj nuk pershkruhet asnje e dhene teknike mbi kushtet e perdorimit dhe instalimit të pajisjes, faktor shume të rendesishem të cilet duhet të jene mire të percaktuar qe ndikojne ne tipologjine e makinerise. Nuk ka asnje të dhene teknike dhe kjo pike 11 ndikon edhe ne piken 12 Mjedisi, ne raport me peshen, dimensionet dhe kushtet teknike të shfrytezimit, të cilat duhet të ishin mire specifikuar.”* KPP bazuar në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të shprehet për këto karakteristika duke qënë se ndikojnë në kushtet e punës ku UPS-si do të instalohet. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të bëjë përshkrimin e kushteve teknike me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi konform kërkesave të përcaktuara nga ky i fundit në dokumentat e tenderit.

III.1.14. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për modifikimin e specifikimit tjetër të vendosur me arsyetimin se *“ Pika Nr.12 - SPECIFIKIME FIZIKE :*

*12.1 - Tek Pershkrimi "PERMASAT LxDxH " me Karakteristika teknike "52x89x 131" sipas pershkrimit të dhene.*

*Ne keto permasa jane të perfshira edhe baterite?!!*

*Permasat nuk duhet te jene fikse, ndaj i kthehem serish konceptit të `perfshirjes".*

*Maksimumi duhet të vendosen dimensionet maksimale të lejuara apo të ambjentit ne dispozicion perfshire ketu edhe dollapin e baterive.*

*12.2 - Tek Pershkrimi "PESHA (kg) " me Karakteristika teknike "202" sipas pershkrimit të dhene.*

*Pike tjeter diskriminuese ose percaktuese (qellimin e vertete të vendosjes se kesaj pike nuk e dime) eshte edhe vendosja e peshes me karakteristike teknike 202?*

*Ne kete eshte e perfshire dhe pesha e baterive??!!*

*Si ne shume pika të skedes teknike ne fjale, edhe tek pika konkrete "Pesha e baterive" jemi ne konceptin e peshes fikse, dhe rithemi serish se jemi ne konceptin e perjashtimit pasi pesha shprehet ne "peshe maksimale e lejuar".* KPP bazuar në asistencën e dhënë nga eksperti i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni gjykon se në lidhje me këtë pikë dhe konkretisht pika 12.1. e specifikimeve teknike “Përmasat Lx D x H” me karakteristika teknike “ 52x89x13” janë përmasa shumë specifike, pra autoriteti kontraktor duhet të japë vlerat maksimale për lartësinë gjerësinë dhe thellësinë në lidhje me vendin ku do të instalohet UPS-i, ndërsa për pikën 12.2. (pesha kg) me të dhëna teknike “202” autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë vlerën maksimale të peshës që duhet të ketë UPS-i dhe kabineti i baterive, në lidhje me aftësinë peshëmbajtëse të godinës të shprehet në kg/m2. Sa më sipër autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet sa më sipër cituar.



III.1.15. Lidhur me pretendimin e ankimuesit me arsyetimin se *“Si perfundim ne preventiv duhet të ishte edhe një ze tjetër per kabllot që lidhen me bateritë me UPS.”* KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike ( neni 19/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit ( neni 12 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.”* KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (*legitimation ad causam*), pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është çënuar nga vendime dhe veprime konkrete ( reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin *sine qua non* të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, duke qenë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar në shtojcën 10 *“Sasia dhe Grafiku i Levrimin”* sasinë e mallit, të gjykuar të nevojshëm. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative ( dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku në nenin 63 pika 4 gërma *“b”* të *lex specialis* parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të *anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj.* Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor ( verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e një zëri në shtojcën 9 të dokumentave të tenderit *“Sasia dhe Grafiku i Levrimin”* në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të

parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër KPP e ka të pamundur të shprehet mbi sasisë e kabullit, (shtim zëri në preventiv) përcaktimi i këtyre të dhënave i takon autoritetit kontraktor. Është në të drejtën e autoritetit kontraktor hartimi i specifikimeve teknike por gjithmonë duke respektuar kushtet e qartësisë së tyre në mënyrë që operatorët ekonomikë të jenë tërësisht të qartë në momentin e hartimit të ofertës së tyre akoma më tepër kur elementë të tillë ndikojnë drejtpërdrejtë në ofertën ekonomike të operatorëve ekonomikë. KPP gjykon se është e nevojshme që autoriteti kontraktor të rishikojë elementët e sipërcituar duke sqaruar ankimuesin për të gjitha paqartësitë e ngritura në ankesë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ABIESSE” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-89869-10-15-2018, me objekt “Blerje UPS 3 (tre) fazor për Reanimacionin e SUT”, me fond limit 2.957.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “ABIESSE” sh.p.k \_\_\_\_\_
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1660 Protokoli, Datë 30.10.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**